

Miratuar me Vendimin nr. 1, datë 17.01.2012 të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve  
Ndryshuar me Vendimin nr. 2, datë 26.01.2012 të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve

## **RREGULLORE**

### **"PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE"**

#### **KREU I:**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**1.1.** Objekti i kësaj Rregulloreje është organizimi i zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve. Objekti i rregullimit janë:

- a) caktimi i njësive zgjedhore;
- b) organizimi dhe funksionimi i komisioneve zgjedhore;
- c) afatet, procedura dhe kompetenca për regjistrimin e kandidatëve;
- ç) afatet, procedura dhe kompetencat për përgatitjen e listës së trupave zgjedhore;
- d) procedura e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve;
- dh) shqyrtimi i ankesave;
- e) rregulla të tjera në lidhje me zgjedhjet.

**1.2.** Kjo rregullore është përgatitur në përputhje me ligjin Nr. 9741, date 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**1.3.** Subjekt i kësaj Rregulloreje është Universiteti i Arteve.

**1.4.** Çdo anëtar i personelit të Universitetit të Arteve ka të drejtën e tij të zgjedhjes dhe të të zgjedhurit, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Rregullore dhe në ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**1.5.** Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese në UART. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit studentë në organet drejtuese të Universitetit të Arteve, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Rregullore dhe në ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.



## **KREU II: PARIMET BAZË**

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

**2.1.** Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Rregullore. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.

**2.2.** Me votë shprehet vetëm një preferencë për secilin post për autoritetet drejtuese. Çdo zgjedhës shpreh aq preferenca sa është edhe numri i vendeve të njësisë përkatëse, në secilën

nga listat me kandidatë për secilin organ drejtues, duke iu referuar numrit përkatës të vendeve sipas kategorive të zgjedhësit.

**2.3.** Çdo zgjedhës e ushtron të drejtën e tij të votës në ditën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe pranë Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit, ku ai është i regjistruar. Administrata e Rektoratit do të votojë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura.

**2.4.** Çdo zgjedhës mund të ushtrojë të drejtën e votës vetëm në se paraqet një dokument zyrtar identifikimi dhe firmos në regjistrin e zgjedhjeve.

**2.5.** Është i ndaluar qëndrimi në mjediset ku zhvillohet votimi i personave që nuk kanë të bëjnë me procesin e votimit, si dhe i zgjedhësve që kanë votuar.

## **KREU III: THIRRJA E ZGJEDHJEVE**

**3.1.** Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall datën e fillimit të procesit zgjedhor në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe datën për zhvillimin e zgjedhjeve të autoriteteve dhe organeve drejtuese në këto institucione.

**3.2.** Zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve, për të gjitha nivelet, zhvillohen në të njëjtën ditë. Nëse është rasti, në të njëjtën ditë zhvillohen nga studentët zgjedhjet për këshillat e studentëve të njësive kryesore apo të UART.

**3.3.** Autoritetet drejtuese nuk mund të zgjidhen për më shumë se dy mandate radhazi në të njëjtin funksion.

**3.4.** Zgjedhjet jashtë radhe për autoritetet dhe organet drejtuese thirren në përputhje me përcaktimet në Statutin e Universitetit të Arteve.



**KREU IV:** Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al  
**ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE**

**4.1** Për organizimin e zgjedhjeve në Universitetin e Arteve ngrihen këto komisione:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i **UART** (këtu e më poshtë referuar si KQZI);
- b. Komisioni i Zgjedhjeve të Fakultetit (këtu e më poshtë referuar si KZF). Në secilin prej Fakulteteve në Universitetin e Arteve ngrihet një KZF.
- c. Komisioni i Ankesave (këtu e më poshtë referuar si KA).

Zgjedhjet organizohen dhe zhvillohen nën drejtimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të UART.

**4.2** Votimi për organet dhe autoritetet drejtuese në të gjitha nivelet, në UART zhvillohen pranë Qendrave të Votimit të njëjësive kryesore. Komisionet e Zgjedhjeve të Fakulteteve janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në njësinë kryesore përkatëse.

**4.3.** Votimi për përgjegjësit e njëjësive bazë (departamenteve) bëhet në njësinë përkatëse, sipas procedurave dhe modaliteteve të përcaktuara nga KZF-ja përkatëse dhe kjo Rregullore.

**4.4.** Autoritetet drejtuese të UART dhe të fakulteteve, si dhe kancelari dhe administratorët, duhet të vënë në dispozicion të procesit të zgjedhjeve, si për autoritetet dhe organet drejtuese, ashtu edhe për këshillat e studentëve të njëjësive kryesore kur është rasti, personelin dhe mbështetjen e nevojshme administrative e materiale.

**KREU V:  
KOMISIONET E ZGJEDHJEVE**

**5.1.** Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në UART (KQZI) emërohen nga Senati Akademik i UART, brenda 4 (katër) ditëve kalendarike nga shpallja e datës së fillimit të procesit zgjedhor. KQZI përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen si më poshtë:

- a. 3 anëtarë emërohen nga personeli akademik, një nga secili Fakultet i UART. Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme, përzgjedh një anëtar të personelit akademik dhe merr vendim për ti a paraqitur propozimin Senatit Akademik.
- b. 1 anëtar emërohet nga personeli joakademik. Kancelari i UART i dërgon Senatit Akademik propozimin për anëtar të KQZI.
- c. 1 anëtar nga studentët. Këshilli Studentor i UART i dërgon Senatit Akademik propozimin për anëtar të KQZI.

Anëtarët e KQZI-së nuk mund të kandidojnë për ndonjë post për autoritete drejtuese. Brenda dy ditëve nga zgjedhja e tij, KQZI-ja zgjedh me shumicë votash, nga përbërja e vet, kryetarin e Komisionit dhe zëvendësin e tij. Ky moment shënon dhe konstituimin e KQZI-së, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet për realizimin e procesit zgjedhor në UART, sipas kësaj rregulloreje dhe ligjit "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë",



i ndryshuar. KQZI shpall menjëherë përbërjen e tij në mjedise të dukshme të UART dhe fakulteteve të tij.

**5.2** Përbërja e Komisioneve të Zgjedhjeve të Fakulteteve (KZF) caktohet nga këshillat e njësive kryesore respektive, brenda tre ditëve kalendarike nga konstituimi i KQZI-së dhe miratohet me Vendim të Senatit Akademik. Çdo KZF përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët emërohen si më poshtë:

- a. 1 anëtar emërohet nga personeli akademik. Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme, cakton një anëtar të personelit akademik dhe ia dërgon për miratim dhe emërim Senatit Akademik.
- b. 1 anëtar emërohet nga personeli joakademik. Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme, cakton një anëtar të personelit joakademik dhe ia dërgon për miratim dhe emërim Senatit Akademik.
- c. 1 anëtar nga studentët e Fakultetit. Këshilli Studentor i Fakultetit i dërgon Senatit Akademik propozimin për anëtar të KZF.

Anëtarët e KZF-ve nuk mund të kandidojnë për ndonjë post për autoritete drejtuese. Senati Akademik në momentin e emërimit të anëtarëve të KZF, emëron si Kryetar Komisioni anëtarin nga personeli akademik. KZF është përgjegjëse për realizimin e procesit zgjedhor në njësinë kryesore përkatëse, nën drejtimin e KQZI-së, mbështetur në këtë rregullore dhe ligjin "Për

arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Vendimet e Senatit për ngritjen e KZF shpallen në mjedise të dukshme të njësisë kryesore përkatëse.

**5.3** Kandidatët për autoritete drejtuese kanë të drejtë të kenë një përfaqësues të tyre si vëzhgues respektivisht pranë KQZI-së dhe KZF-ve, të cilët mund të ndjekin të gjitha veprimtaritë për zgjedhjet dhe mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e komisionit të zgjedhjeve, pranë të cilit janë atashuar. Kandidatët për autoritete drejtuese i komunikojnë KZF-ve emrat e personave që caktohen si përfaqësues të tyre.

**5.4** Përbërja e Komisionit të Ankesave (KA) miratohet nga Senati Akademik i UART, brenda dy ditëve kalendarike nga data e fillimit të procesit zgjedhor.

KA përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, nga personeli akademik i secilit Fakultet. Anëtarët e KA emërohen nga Senati Akademik, i cili përzgjedh ndër dy propozime të paraqitura nga secili Këshill i Fakultetit. Senati Akademik përcakton edhe anëtarin i cili do të emërohet Kryetar i KA.

Anëtarët e KA-së nuk mund të kandidojnë për ndonjë post për autoritete drejtuese. Vendimi i Senatit Akademik për përbërjen e KA shpallet në mjediset e secilit Fakultet.

**5.5.** Regjistrimi i kandidatëve për poste të autoriteteve dhe organeve drejtuese, përcaktuar në pikën 6.1. të kësaj Rregulloreje, bëhet nga KQZI. Individët që dëshirojnë të kandidojnë, paraqesin KQZI-së kërkesën e tyre për kandidim shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar, brenda pesë ditëve kalendarike nga konstituimi i KQZI.



KQZI-ja verifikon plotësimin nga kandidatët e paraqitur të kriterëve të parashikuara në këtë Rregullore dhe sipas ligjit "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZI-ja zyrtarizon kandidatët, duke i renditur ata në lista të veçanta për çdo post autoriteti drejtues më vete. Për organet drejtuese, listat e kandidatëve do të jenë të veçanta sipas organeve drejtuese (Senat Akademik/Këshill i Administrimit/Këshill i Njësisë Kryesore) dhe sipas kategorive të ndryshme (personel akademik, personel joakademik dhe studentë).

**5.6.** KQZI-ja afishon listat e kandidatëve për postet e autoriteteve drejtuese Rektor dhe Dekan, listat e kandidatëve për përgjegjës të njësive bazë, si dhe listat e kandidatëve për organet drejtuese, në mjedise të dukshme të UART dhe fakulteteve përbërëse të tij, jo më vonë se dhjetë ditë nga data e konstituimit të tyre.

**5.7.** Listat e zgjedhësve, hartohen më vete për përfaqësues të kategorive të ndryshme të trupës zgjedhore:

a) personel akademik; b) personel joakademik; c) studentë.

Këto lista përgatiten nën përgjegjësinë e Rektoratit e dekanateve dhe ju dorëzohen KZF-ve jo më vonë se dhjetë ditë nga data e fillimit të procesit zgjedhor në Universitetin e Arteve.

**5.8.** KZF-të afishojnë menjëherë listat paraprake të zgjedhësve në mjedise të dukshme të fakultetit përkatës.

**5.9.** Për çdo problem lidhur me listat e zgjedhësve, zgjedhësit duhet të njoftojnë KZF-në përkatëse, brenda tre ditëve kalendarike, nga shpallja e listave paraprake. Brenda dy ditëve kalendarike pas përfundimit të afatit të reklamimit të gabimeve në lista, KZF-të marrin vendim mbi reklamimet e bëra dhe të afishojnë listat përfundimtare të zgjedhësve.

**5.10.** KZF-të dorëzojnë kopje të këtyre listave në KQZI. KQZI i publikon ato në mjedise të dukshme të UART.

**5.11.** KQZI-ja mbështetur në listat e veçanta që tregohen në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, për secilin organ drejtues (Senat Akademik, Këshill Administrimi, Këshill i Njësisë Kryesore) dhe për çdo post autoriteti drejtues, përgatit fletëvotimet jo më vonë se 3 ditë kalendarike para datës së caktuar për zhvillimin e zgjedhjeve.

**5.12.** Në rastet kur një anëtar i KZF nuk paraqitet në detyrë apo kryen veprime të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi apo me Rregulloren e Zgjedhjeve, atëherë KQZI ka tagrin për të vendosur shkarkimin e anëtarit të KZF dhe emërimin e një anëtar tjetër zëvendësues. Në këtë rast KQZI mund të marrë në konsideratë propozimet e bëra nga subjektet e interesuara.



**5.13.** Në rastet kur një anëtar i KQZI apo KA nuk paraqitet në detyrë apo kryen veprime të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi apo me Rregulloren e Zgjedhjeve, atëherë Senati Akademik ka tagrin për të vendosur shkarkimin e anëtarit të KQZI apo KA dhe emërimin e një anëtarit tjetër zëvendësues. Në këtë rast Senati Akademik mund të marrë në konsideratë propozimet e bëra nga subjektet e interesuara.

## **KREU VI: PARAQITJA E KANDIDATEVE**

**6.1.** Paraqitja e kandidatëve për konkurrim për të gjitha nivelet fillon që nga momenti i konstituimit të KQZI dhe përfundon brenda pesë ditëve kalendarike. KQZI do të pranojë dokumentacionin e kandidatëve vetëm nga ora 09.00 deri në orën 16.00 të çdo dite brenda periudhës së regjistrimit.

**6.2.** Kryetari i KQZI i lëshon secilit kandidat të regjistruar për autoritetet drejtuese, një vërtetim regjistrimi, ku evidentohet edhe data e regjistrimit.

**6.3.** Fletë-aplikimi i një kandidati për konkurrim për autoritet drejtues apo anëtar i një organi drejtues, duhet të përmbajë gjeneralitetet e plota, vendin e punës dhe postin për të cilin kandidon.

Kur kandidati është anëtar i personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në UART, për regjistrim paraqet vetëm fletë aplikimin për konkurrim për autoritet drejtues apo anëtar i organit drejtues.

Kur kandidati nuk është anëtar i personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në UART, përveç fletë aplikimit për konkurrim për autoritet drejtues për regjistrim paraqet një CV, kopje të Diplomës, një fotokopje të një dokumenti identifikimi zyrtar, dëshminë e gradës e titullit, dëshminë e penalitetit.

Kandidati për autoritet drejtues rektor/dekan duhet të paraqesë edhe programin e tij për zhvillimin e UART apo njësisë përkatëse.

**6.4.** Universiteti i Arteve duhet t'u japë mundësi të barabarta dhe t'u ofrojë kushte të njëjta të gjithë kandidatëve për të marrë pjesë në konkurrim, të drejtën që të bëjnë paraqitjen e programeve të tyre zgjedhore në çdo formë dhe mënyrë të ligjshme përfshirë dhe mundësinë e organizimit të takimeve me zgjedhësit në ambiente të përshtatshme, etj.

## **KREU VII: KRITERET PËR KANDIDATET**

**7.1.** Kandidatët për anëtar i Senatit Akademik, anëtar i zgjedhur i Këshillit të Administrimit, anëtar i Këshillit të Fakultetit, si dhe për autoritetet drejtuese: Rektor, Dekan dhe Përgjegjës njësie bazë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë

rregullore, në ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe në Statutin e UART.

**7.2.** Kandidati për anëtar i zgjedhur në Këshillin e Administrimit:

- a) nuk mund të kandidojë edhe për anëtar i Senatit Akademik, për postin e Rektorit, të dekanit apo përgjegjësit të departamentit;
- b) duhet të ketë së paku gradën shkencore "Doktor";

**7.3.** Kandidati për anëtar i Senatit Akademik nga personeli akademik:

- a) nuk mund të kandidojë njëkohësisht edhe për anëtar i zgjedhur i Këshillit të Administrimit;
- b) duhet të ketë së paku gradën shkencore "Doktor".

**7.4.** Numri i anëtarëve të Këshillit të Fakultetit përveç përbërjes sipas përcaktimeve në nenin 33 të Statutit të UART, duhet të pasqyrojë edhe strukturën numerike të personelit akademik të çdo njësie bazë.

**7.5.** Për zgjedhjet e vitit 2012, anëtarët e Këshillit të Fakultetit për çdo Fakultet do të zgjidhen duke pasur përcaktimin e mëposhtëm:

- a. Fakulteti i Muzikës:
  - i. 3 anëtarë nga Departamenti i KMD;
  - ii. 3 anëtarë nga Departamenti i Interpretimit;
  - iii. 1 anëtar nga personeli joakademik
  - iv. 1 anëtar nga Studentët
  - v. Dekani është i zgjedhur për shkak të funksionit
- b. Fakulteti i Artit Skenik:
  - i. 3 anëtarë nga Departamenti i Aktrimit dhe Regjisë së filmit e Televizionit;
  - ii. 3 anëtarë nga Departamenti i Regji, Skenografi, Koreografi, Teori e Arteve;
  - iii. 1 anëtar nga personeli joakademik
  - iv. 1 anëtar nga Studentët
  - v. Dekani është i zgjedhur për shkak të funksionit
- c. Fakulteti i Arteve të Bukura:
  - i. 4 anëtarë nga Departamenti i Pikturës
  - ii. 2 anëtarë nga Departamenti i Skulpturës
  - iii. 1 anëtar nga personeli joakademik
  - iv. 1 anëtar nga Studentët
  - v. Dekani është i zgjedhur për shkak të funksionit

**7.6.** Kandidati për postin e një autoriteti drejtues, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Statutin e UART.

Mund të konkurrojnë për postin e një autoriteti drejtues edhe kandidatë nga jashtë UART, që plotësojnë kriteret e mësipërme dhe formimi i tyre akademik përkon me ato të UART/njësisë përkatëse. Nëse kandidatë të tillë rezultojnë fitues për postin e një autoriteti drejtues, ata punësohen me kohë të plotë në postin përkatës brenda UART.



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

**7.7.** Kandidati për postin e autoritetit drejtues - përgjegjës i njësisë baze, duhet të ketë së paku gradën shkencore "Doktor".

**7.8.** Kandidati për autoritet drejtues në UART, nuk mund të kandidojë për më shumë se një post autoriteti drejtues në të njëjtën kohë.

**7.9.** Kandidatët nga personeli joakademik për anëtarë të Senatit Akademik, duhet të kenë arsim të lartë.

**7.10** Kandidatët nga studentët për anëtarë të Senatit Akademik, anëtar i zgjedhur i Këshillit të Administrimit të UART, apo anëtarë të Këshillave të Fakulteteve, duhet të jenë kandidatë që ndjekin studimet në UART apo fakultet përkatëse. Kandidatët e mësipërm duhet të kenë një mesatare notash në vitin akademik paraardhës mbi 7 (shtatë).

**7.11** Nuk mund të kandidojnë për ndonjë post autoritet drejtues apo anëtar në organet drejtuese të UART, persona që janë duke vuajtur dënim me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale apo kundravajtje penale ose që janë dënuar më parë për vepra penale a kundravajtje penale.

Nuk kanë të drejtë të kandidojnë për autoritete drejtuese apo për anëtarë në organe drejtuese, persona të cilët mbushin moshën e daljes në pension brenda kohëzgjatjes së mandatit.

## **KREU VIII: TRUPAT ZGJEDHËSE**

**8.1.** Trupa zgjedhëse për Rektorin në UART përbëhet nga:

- a) personeli akademik i UART, i cili është i punësuar me kohë të plotë, brenda numrit të punonjësve të miratuara nga Ministri i ASH.
- b) personeli joakademik i UART i punësuar me kohë të plotë.
- c) studentët të cilët ndjekin studimet me kohë të plotë në UART.

**8.2.** Trupa zgjedhëse për dekanin përbëhet nga:

- a) personeli akademik i fakultetit, i cili është i punësuar me kohë të plotë, duke respektuar për analogji përcaktimin në pikën 8.1 më sipër.
- b) personeli joakademik i fakultetit, i cili është i punësuar me kohë të plotë.
- c) studentët të cilit ndjekin studimet me kohë të plotë në atë fakultet.

**8.3.** Trupa zgjedhëse për përgjegjës të një njësie baze përbëhet nga personeli akademik i njësisë respektive, i cili është i punësuar me kohë të plotë.

**8.4.** Trupa zgjedhëse për përfaqësuesit e personelit akademik të fakulteteve në Këshillat e Fakulteteve, në Senatit Akademik dhe në Këshillin e Administrimit, përbëhet nga personeli akademik i fakultetit respektiv i punësuar me kohë të plotë.





**8.5.** Trupa zgjedhëse për përfaqësuesit e personelit joakademik të fakulteteve në Këshillat e Fakulteteve përbëhet nga personeli administrativ e teknik dhe nga personeli teknik e punëtor i fakultetit, i punësuar me kohë të plotë.

**8.6.** Trupa zgjedhëse për përfaqësuesit e personelit joakademik të UART (fakulteteve dhe rektoratit) në Senatin akademik, përbëhet nga personeli administrativ e teknik, nga personeli bibliotekar dhe nga personeli teknik e punëtor i UART, i punësuar me kohë të plotë.

**8.7.** Trupa zgjedhëse për përfaqësuesit e studentëve të fakulteteve në Këshillat e Fakulteteve përbëhet nga studentët me kohë të plotë studimi të fakulteteve respektive.

**8.8.** Trupa zgjedhëse për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik përbëhet nga studentet me kohe te plote studimi te Fakulteteve respektive.

**8.9.** Trupa zgjedhëse për përfaqësuesin e studentëve në Këshillin e Administrimit përbëhet nga Këshilli i Studentëve të UART.

**8.10.** Në zgjedhjen e autoriteteve drejtuese, votat e studenteve dhe votat e personelit joakademik llogariten me përqindje. Ato vlejnë 20 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për studentët dhe 5 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për personelin joakademik.

## **KREU IX: MODELI DHE ADMINISTRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT**

**9.1** Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZI.

**9.2** Fletët e votimit për autoritete të ndryshme drejtuese, për anëtarë të organeve të ndryshme drejtuese dhe që ju përkasin trupave të ndryshme zgjedhëse, të jenë me ngjyra të ndryshme dhe të dallueshme nga ana vizuale.

**9.3** Në krye të secilës fletë votimi vendoset emërtesa e saj.

**9.4** Në fletën e votimit vendosen emrat e kandidatëve për postin të cilit i përket ajo fletë votimi, sipas rendit alfabetik.

**9.5** Për secilin kandidat në fletën e votimit shkruhet:

- Emri, atësia, mbiemri i kandidatit, sikurse figuron në dokumentacionin e kandidimit.
- Grada/titulli i kandidatit.

Në rastet kur ka vetëm një kandidat në fletën e votimit, të krijohet mundësia e votimit kundër.

**9.6** Modeli i secilës fletë votimi, miratohet nga KQZI. Para se të shpërndahen fletët e votimit për secilën KZF, KQZI vulos të gjitha fletët e votimit me vulën e KQZI-së. Vula e KQZI-së përmban tekstin "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve UART"

**9.7** Fletët e votimit vulozen në pjesën e pasme me vulën e KZF-së.

**9.8** Vula e KZF-së përmban tekstin "Komisioni Zgjedhor i Fakultetit [*emri i fakultetit*]".

**9.9** KZF-të e njëjësive kryesore tërheqin në KQZI materialet e mëposhtme:

- Fletët e votimit në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në KZF-në përkatëse;
- Vulën e KZF-së;
- Zarfin në të cilin është shënuar "Fletë të dëmtuara";
- Zarfin në të cilin është shënuar "Fletë votimi të papërdorura";
- Zarfin në të cilin është shënuar "Zarfi i procesverbaleve të vulosura".

**9.10** Administrimi i fletëve të votimit do të bëhet nga KZF-të përkatëse deri në momentin e numërimit të votave. Pas numërimit dhe ndarjes së fletëve të votimit dhe përgatitjes së procesverbaleve, zarfet e mësipërm, dërgohen në KQZI.

## **KREU X VOTIMI**

**10.1** Votimi bëhet në qendrat e votimit pranë fakulteteve. KZF-ja funksionon edhe si komision votimi në qendrën e votimit të fakultetit.

**10.2** Votimet për autoritetet dhe organet drejtuese të të gjitha niveleve në Universitetin e Arteve, zhvillohen në një ditë të vetme, në datën e caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ato fillojnë në orën 08.00 dhe vazhdojnë deri në orën 16.00. Nëse në orën 16.00 ka zgjedhës që presin për të votuar ata futen në mjediset e qendrës së votimit dhe KZF mbyll derën me qëllim mos lejimin e hyrjes së personave të tjerë. KZF shpall të mbyllur procesin e votimit me votimin e zgjedhësit të fundit dhe largimin e zgjedhësve nga mjediset e qendrës së votimit.

**10.3** KZF-të tërheqin pranë KQZI-së materialet e votimit në ditën e zgjedhjeve në orën e caktuar nga KQZI-ja.

**10.4** Procesin e votimit të trupave zgjedhëse në cdo fakultet e drejton kryetari i KZF-së, në prani të anëtareve të Komisionit.

KZF-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe në prani të vëzhguesve të kandidatëve, një orë përpara hapjes së votimit, kryen këto detyra:

- a) vendos tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
- b) heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 100 m;
- c) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
- ç) vendos materiale të tjera të kërkuara nga KQZI-ja;



d) kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;

dh) u tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta dhe i mbyll ato, sipas procedurës së përcaktuar në shkronjën "e" të kësaj pike;

e) në një nga faqet anësore të kutisë shënon qartë numrin e qendrës së votimit, si dhe vendos shenja dalluese, që i bëjnë të qartë zgjedhësit se ku duhet të hedhë çdonjërin nga fletët e votimit.

Anëtarët e KZF-së, në prani të vëzhguesve, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

**10.5** Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara më sipër, kryetari i KZF-së deklaron hapjen e votimit jo më përpara orës së parashikuar në pikën 10.2 të kësaj Rregullore.

**10.6** Çdo zgjedhës do të votojë vetëm nëse paraqet një dokument zyrtar identifikimi si më poshtë:

- Kartë identiteti
- Pasaportë
- Lejedrejtimit automjeti

Zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon në krah të emrit të kandidatit shenjën "X" ose "+".

**10.7** Votimi për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese bëhet me listë kandidatësh. Secili zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për secilin post për autoritet drejtues. Kandidatët për secilin post për autoritet drejtues duhet të jenë në të njëjtën listë.

**10.8** Votimi për organet drejtuese bëhet me listë kandidatësh. Secili zgjedhës ka të drejtën të shprehë aq preferenca sa është edhe numri i vendeve të njësisë përkatëse në secilën nga listat me kandidatë për secilin organ drejtues (p.sh. Nëse një njësi kryesore ka 4 vende për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik, ai mund të votojë për deri në tre preferenca, pasi një vend në SA, automatikisht është i Dekanit. Kandidatët për secilin organ drejtues prej secilës nga tre kategoritë e përcaktuara (personel akademik, personel joakademik apo studentë me kohë të plotë) duhet të jenë në listën përkatëse sipas kategorisë.

**10.9** Konsiderohen të pavlefshme fletët e votimit që:

- kanë shenja që nuk japin mundësi të identifikohet kandidati i përzgjedhur.
- nuk janë fletë votimi të ofruara sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore si dhe në akte të tjera nënligjore në zbatim të saj;
- mbajnë shenja që deklarojnë identitetin e zgjedhësit;
- votojnë për persona që nuk janë në listën e kandidatëve;



- nuk votojnë për asnjë nga kandidatët apo nuk zgjedhin asnjë alternative në rastet kur ka një kandidat të vetëm.
- shprehin më shumë se një preferencë në listën e kandidatëve për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese.
- shprehin më shumë preferenca sesa numri i caktuar i vendeve në listën e kandidatëve për zgjedhjen e organeve drejtuese.

Fletët e votimit të pavlefshme konsiderohen vetëm për llogaritjen e numrit të pjesëmarrësve në votim.

## **KREU XI NUMËRIMI I VOTAVE DHE SHPALLJA E FITUESVE**

**11.1** Numërimi i votave bëhet në KZF, pas përfundimit të votimit në qendrën e votimit, përjashtuar votat për Rektor. KZF me përfundimin e procesit të votimit mbyll kutitë e votimit dhe të harton procesverbalet përkatëse për mbylljen e votimit.

**11.2** KQZI shpall të mbyllur procesin e votimit pasi ka përfunduar votimi në të gjitha qendrat e votimit të UART. Menjëherë pas kësaj fillon procesi i numërimit të votave në të gjitha KZF-të e UART. Vëzhguesit kanë të drejtë të ndjekin këtë proces. Me fillimin e procesit të numërimit të votave, kutitë e votimit duhet të jenë të mbyllura, Kutitë e votimit të hapura nuk janë të vlefshme.

**11.3** KZF bën numërimin e votave për secilin kandidat për postin e autoriteteve drejtuese dekan dhe përgjegjës departamenti si dhe për secilin organ drejtues të votuar. Ajo llogarit rezultatet e votimit të kandidatëve për postin e dekanit, sipas formulës në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, duke mbajtur në konsideratë peshat e votimit për secilën trupë zgjedhëse, dhe nxjerr rezultatit për përgjegjësit e njësive bazë si dhe listat me përbërjen e anëtarëve në Këshillin e Fakultetit. KZF dërgon në KQZI rezultatit e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese Dekan dhe Përgjegjës të njësive bazë si dhe listën e anëtarëve në Këshillin e Njësive Kryesore për shpallje.

**11.4** Numërimi i votave për Rektor bëhet nga KQZI. Me mbylljen e votimit dhe kutive të votimit, KZF-ja harton procesverbalin përkatës të mbylljes dhe kutitë e votimit si dhe materiale të tjera që lidhen me votimin për Rektor i dorëzohen KQZI. Dorëzimi bëhet me procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KZF dhe gjithë anëtarët e KQZI. KQZI ka detyrë që të tërheqë kutitë e votimit në secilin KZF.

Që nga momenti i marrjes në dorëzim të kutive deri në përfundim të procesit të numërimit të votave, pranë KQZI mund të qëndrojnë kandidatët për postin e autoritetit drejtues Rektor, ose përfaqësuesit e tyre. KQZI llogarit rezultatit e votimit për secilin kandidat sipas formulës në aneksin bashkëngjitur kësaj Rregullore.

**11.5** KZF-ja, pasi kryen numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve të votimeve, dërgon në KQZI sa më poshtë:

- a. Emrin e kandidatit fitues për Dekan të Fakultetit përkatës;



- b. Emrat e kandidatëve fitues për anëtar të Senatit Akademik të zgjedhur nga personeli akademik i Fakultetit përkatës;
- c. Numrin e votave të marra në Fakultetin përkatës, për secilin kandidat për anëtar të Senatit Akademik;
- d. Emrin e kandidatit fitues për anëtar të Senatit Akademik të zgjedhur nga studentët e Fakultetit përkatës;
- e. Emrin e kandidatit fitues për anëtar të Këshillit të Administrimit të zgjedhur nga personeli akademik i Fakultetit përkatës.
- f. Emrat e kandidatëve fitues për Këshillin e Fakultetit;
- g. Emrin e kandidatit fitues për Përgjegjës Departamenti për secilin Departament të Fakultetit përkatës.

**11.6** KZF dërgon në KQZI edhe procesverbalet e mbajtura lidhur me procesin e numërimit të votave dhe nxjerrjen e rezultateve në rastet që ajo është kërkuar. KZF-të shpallin listat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Fakultetit të renditur sipas pikëve

**11.7** KQZI përgatit listën e anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Administrimit mbështetur në rezultatet e ardhura nga KZF-të. Përfaqësuesi nga studentët në Këshillin e Administrimit zgjidhet nga Këshilli i Studentëve të UART. Këshilli Studentor i UART dërgon në KQZI emrin e studentit i cili është zgjedhur anëtar i Këshillit të Administrimit.

**11.8** Konsiderohet fitues në postin e autoriteteve drejtues Rektor, dekan dhe përgjegjës të njësisë bazë, kandidati i cili është renditur i pari në listë dhe rezultati i tij në përqindje është jo më i vogël se 33%. Nëse nga llogaritja e rezultetit të votimit kanë dalë dy ose më shumë kandidatë me pikë të barabarta, fituesi do të zgjidhet me short. Shorti hidhet në KQZ, në prani të kandidatëve apo përfaqësuesve të tyre. Për efekt të llogaritjes së pikëve në përqindje, do të konsiderohet përqindja deri dy shifra pas presjes dhjetore (p.sh. 20,12%)

Në rastin e një kandidature të vetme për postin e autoriteteve drejtues Rektor, dekan dhe përgjegjës të njësisë bazë, konsiderohet fitues nëse rezultati i tij në përqindje është jo më i vogël se 50% të votave të vlefshme.

**11.9** Kur asnjë kandidat nuk rezulton fitues sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, brenda dy javëve nga dita e votimit, zhvillohet rasti i dytë i zgjedhjeve midis dy kandidatëve me rezultatin më të lartë. Në raundin e dytë shpallet fitues kandidati që arrin rezultatin më të lartë. Data e zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve caktohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

**11.10** Në rastet kur në listat e kandidateve për anëtarë të Senatit Akademik, Këshillit të Administrimit dhe Këshillit të Fakultetit kandidatët e renditur brenda numrit të parashikuar të anëtareve kanë numër të barabartë votash, kandidati fitues zgjidhet me short. Shorti hidhet nga Komisioni i cili nxjerr fituesit për organet drejtuese përkatëse, sipas kategorive.





**11.11** Në rast se nuk paraqitet asnjë kandidat për një post të caktuar autoriteti drejtues, zgjedhjet për këtë pozicion përsëriten pas një periudhe një vjeçare. Këto zgjedhje organizohen sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

## **KREU XII: ANKIMI**

**12.1** Në Universitetin e Arteve, njihet e drejta për ankim lidhur me zbatimin dhe respektimin e procedurave, kriterëve dhe llogaritjen e rezultateve të zgjedhjeve.

**12.2** Ankimet që kanë të bëjnë me respektimin e procedurave dhe zhvillimin e fushatës së zgjedhjeve si dhe organizimin e votimeve për të gjitha nivelet, deri ditën e votimit (përfshirë edhe këtë ditë) i drejtohen me shkrim KQZI-së, i cili pasi e shqyrton merr masat përkatëse.

**12.3** Ankesat që kanë të bëjnë me vendimet lidhur me rezultatet e votimit dhe shpalljen e fituesve i paraqiten me shkrim Komisionit të Ankesave brenda tri ditësh nga shpallja e rezultatit të votimit. Komisioni i Ankesave thërret për sqarim Anëtarët e Komisionit të Zgjedhjeve përkatës kur e gjykon të arsyeshme, gjithashtu edhe ankuesin.

**12.4** Komisioni i Ankesave merr vendim brenda tre ditëve me shumicë votash të anëtarëve të tij. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe të pasqyrojë edhe mendimin kundër nëse është rasti.

**12.5** Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar. Vendimi i Komisionit të Ankesave i dërgohet KQZI për ekzekutim.

## **KREU XIII: PËRCJELLJA E KANDIDATËVE TË ZGJEDHUR DHE EMËRIMI I TYRE**

**13.1** Kandidati i shpallur fitues nga KQZI-ja për secilin post të autoriteteve drejtuese i përcillet për kompetencë organit të emërtesës sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kandidatët fitues për autoritetet drejtuese, shoqërohen me procesverbalin dhe vendimin KQZI-së për shpalljen e fituesve, me deklaratë pranuese të të zgjedhurve dhe nëse ka ankim, dokumentacionin e plotë të tyre dhe vendimet përkatëse.

**13.2** Organet e emërtesës duhet të ushtrojnë të drejtën e emërimit brenda një muaji, nga data e paraqitjes së kandidaturës.

**13.3** Anëtarët e organeve drejtuese: Senat Akademik, Këshill i Administrimit dhe Këshilla të njësive kryesore shpallen nga KQZI-ja. Këto organe drejtuese fillojnë veprimtarinë e tyre me thirrjen e mbledhjes së parë.



**KREU IV:** Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

**14.1** Autoritetet dhe organet drejtuese në UART, gjatë procesit zgjedhor vazhdojnë të ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre përveç punësimit të personelit akademik dhe administrativ.

**14.2** Në rastet kur për pozicionet e autoriteteve drejtuese në UART, nuk kandidon asnjë kandidat i cili të mund të plotësojë kriteret e vendosura në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, apo Statutin e UART, autoriteti drejtues i atij pozicioni do të zgjidhet sipas procedurave të përcaktuara për rastet e një Institucioni të ri publik të Arsimit të Lartë deri në organizimin e zgjedhjeve të pjesshme në atë njësi apo UART.

**14.3** Dokumentacioni i zgjedhjeve bëhet në dy kopje, nga të cilat njëra ruhet në Arkivin e UART, kurse tjetra i përcillet organit të emërtesës.

**14.4** Në të gjitha votimet për zgjedhjet mbahen procesverbale. Procesverbalet nënshkruhen nga anëtarët e pranishëm të komisionit dhe nëse dëshirojnë edhe nga përfaqësuesit e kandidatëve për autoritete drejtuese.

**14.5** Fletët e votimit në kutitë e votimit, pas numërimit sipas emërtesës së tyre, arkivohen dhe ruhen deri në një vendim të Senatit Akademik.



## **ANEKS 1 FLETE VOTIMI QE DO TE PERGATITEN PER TE VOTUAR PRANE KZF-VE:**

### **15.1 Për personelin akademik:**

- 15.1.1 Lista e kandidateve për rektor;
- 15.1.2 Lista e kandidateve për dekan;
- 15.1.3 Lista e kandidateve për përgjegjës Departamenti;
- 15.1.4 Lista e kandidateve nga personeli akademik për anëtare të Senatit akademik;
- 15.1.5 Lista e kandidateve për anëtarin e zgjedhur nga personeli akademik për Këshillin e administrimit;
- 15.1.6 Lista e kandidateve nga personeli akademik për anëtarë të Këshillit të Fakultetit;

### **15.2 Për personelin joakademik:**

- 15.2.1 Lista e kandidateve për rektor;
- 15.2.2 Lista e kandidateve për dekan;
- 15.2.3 Lista e kandidateve nga personeli joakademik i UART për anëtarë të Senatit akademik;
- 15.2.4 Lista e kandidateve nga personeli joakademik për anëtarë të Këshillit të Fakultetit;

### **15.3 Per studentet:**

- 15.3.1 Lista e kandidateve për rektor;
- 15.3.2 Lista e kandidateve për dekan;
- 15.3.3 Lista e kandidateve nga studentet për anëtarë të Senatit akademik;
- 15.3.4 Lista e kandidateve nga studentët për anëtarë të Këshillit të Fakultetit;

Listat e kandidateve për postin e autoritetit drejtues rektor/dekan dhe për përfaqësuesit e kategorive të ndryshme në organet drejtuese, të jenë të dallueshme nga njëra tjetra për çdo trupë zgjedhëse, nëpërmjet ngjyrave dhe/ose tekstit.



## ANEKS 2

Llogaritja e përqindjes fituese për kandidatet për rektor e dekan do të behet sipas formulës:

$$R\% = \frac{A}{N_1} \times 75\% + \frac{B}{N_2} \times 5\% + \frac{C}{N_3} \times 20\%$$

Ku R% është rezultati i shprehur ne përqindje i një kandidati për një pozicion te caktuar.

- A është numri i votave pro kandidat nga personeli akademik.
- N1 është numri i përgjithshëm i votave te vlefshme nga personeli akademik.
- B është numri i votave pro kandidat nga personeli joakademik.
- N2 është numri i përgjithshëm i votave te vlefshme nga personeli joakademik.
- C është numri i votave pro kandidat nga studentet.
- N3 është numri i përgjithshëm i votave te vlefshme nga studentet.